



Open
Government
Partnership



Raporti i Konsultimit Publik
Raporti i Monitorimit/Raporti i Vetëvlerësimit
Plani Kombëtar i Veprimit 2020-2022

OGGP

Shtator 2021

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK

I. Titulli i draft aktit

Raporti i vetëvlerësimit për periudhën Janar - Dhjetor 2020 (raporti vjetor) dhe Janar- Qershor 2021, i Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur, 2020-2022.

II. Kohëzgjatja e konsultimeve

Draft raporti i vetëvlerësimit është konsultuar sipas 4 komponentëve. Më specifikisht si më poshtë vijon:

Komponenti 1: Antikorrupsion

- Draft raporti i vetëvlerësimit për periudhën vjetore të vitit 2020 dhe janar - qershor 2021 për komponentin antikorrupsion dhe më konkretisht për objektivin specifik - planet e integritetit, është përgatitur nga njësia përgjegjëse në Drejtorinë e Programeve dhe Projekteve në fushën e Antikorrupsionit në Ministria e Drejtësisë. Raporti është konsultuar me organizatat bashkëpunëtoresh të MD por edhe me publikun e gjerë dhe grupe interesi që ndjekin dhe asistojnë platformën e qeverisjes së hapur.
- Draft raporti i është dërguar OSHC-ve nëpërmjet email (nga adresa rovana.pregjia@drejtesia.gov.al) dhe ka zgjatur 8 ditë pune (nga 29 korriku deri më 9 gusht 2021).
- Draft raporti është shpërndarë në platformën OGP, <https://ogp.gov.al/artikull/raporte-monitorimi-lufta-kunder-korrupsionit>, nëpërmjet AKSHI dhe ka zgjatur 5 ditë pune (nga 4 gusht deri më 10 gusht 2021).

Komponenti 2: Qeverisja Digjitale

- Në zbatim të Urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” dokumenti u dërgua për komente dhe të përfaqësues të Grupit Tematik “Digjitalizimi dhe e-Qeverisja”, përkatësisht të 25 përfaqësues nga 25 institucione të ndryshme në administratën publike.
- Gjithashtu, drafti i raportit të vlerësimit u përcoll përmes postës elektronike edhe të përfaqësues nga shoqëria civile me të cilët ka pasur takime gjatë kësaj periudhe dhe kanë qenë të interesuar mbi politikën e hapura të qeverisë me një fokus në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e Planit Kombëtar të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, konkretisht të përfaqësues nga US - Albania Transparency Academy Support Project, përfaqësues nga Lëvizja MJAFIT dhe përfaqësues nga Institute VISUM For The Blinds.

Komponenti 3: Qeverisja e Hapur në Drejtësi

- Konsultim me të gjithë aktorët e interesit, me të cilët Ministria e Drejtësisë konsulton dokumentat strategjike në fushën e drejtësisë;
- Publikim në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë duke caktuar një adresë e-maili për marrjen e komenteve/sugjerimeve;
- Publikim në faqen zyrtare të OGP-së, duke caktuar një adresë e-maili për marrjen e komenteve/sugjerimeve.

Komponenti 4: Qeverisja e Hapur Fiskale

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, institucioni lider për komponentin 4 “Transparenca Fiskale” e Planit të Veprimtë OGP-së 2020 – 2022, përgatiti raportin e Vetëvlerësimit për periudhën 2020 – 6 maji i parë 2021.
- Raporti u përgatit bazuar në kontributet e njësisve përgjegjëse për zbatimin e masave të planit të veprimtë. Pas marrjes së konfirmimeve nga njesitë përgjegjëse për versionin final të raportit, u vijua me procesin e konsultimit me organizata e shoqërisë civile.

III. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë raport janë:

Komponenti 1: Antikorrupsion

- Dërguar via email (nga rovena.pregja@drejtesia.gov.al) tek OSHC-të për komente dhe opinione, nga data 29 korrik 2021 - 9 gusht 2021. Është dërguar draft raporti i vetëvlerësimit dhe PKVPQH (OGP) 2020-2022, i miratuar (bashkangjitur). Është vendosur një adresë kontakti për dërgimin e komenteve, etj. Është njoftuar gjithashtu takimi i ardhshëm i GT të P-B, më 10 shtator 2021.
- Publikuar nëpërmjet platformës OGP nëpërmjet AKSHI, një kre i veçantë (Raporti Monitorimit) me një tekst njoftimi shoqërues. Është vendosur adresa e pikës së kontaktit rovena.pregja@drejtesia.gov.al, për dërgimin e komenteve, etj.

Komponenti 2: Qeverisja Digjitale

- Për sa më sipër, përgjatë një jave (03.08.2021-10.08.2021), Organizata të Shoqërisë Civile, akademikët, qytetarët dhe të gjithë të interesuarit ishin të ftuar të jepnin kontributin e tyre mbi këtë dokument – raport vetë-vlerësimi.
- Në zbatim të Urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” dokumenti u dërgua për komente dhe te përfaqësues të Grupit Tematik “Digjitalizimi dhe e-Qeverisja”, përkatësisht te 25 përfaqësues nga 25 institucione të ndryshme në administratën publike.
- Gjithashtu, drafti i raportit të vlerësimit u përcoll përmes postës elektronike edhe te përfaqësues nga shoqëria civile me të cilët kemi pasur takime gjatë kësaj periudhe dhe kanë qenë të interesuar mbi politikën e hapura të qeverisë me një fokus në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e Planit Kombëtar të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, konkretisht te përfaqësues nga US - Albania Transparency Academy Support Project, përfaqësues nga Lëvizja MJAFT dhe përfaqësues nga Institute VISUM For The Blinds.

Komponenti 3: Qeverisja e Hapur në Drejtësi

- Dërguar *via email* organizatave të shoqërisë civile për komente e sugjerime, date 30 korrik 2021.
- Publikuar në <https://drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-2/> nga data 30.07.2021 – 10.08.2021
- Publikuar në <https://ogp.gov.al/artikull/drejtesi>
- Me qëllim marrjen e komenteve/sugjerimeve për të përmirësuar raportin dhe cilësinë e tij si dhe në kuadër të transparenës, është vendosur adresa e specialistit të Sektorit të Strategjive/Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, znj.DesianaTodolli, desiana.todolli@drejtesia.gov.al

Komponenti 4: Qeverisja e Hapur Fiskale

- Në datën 28 korrik 2021, nëpërmjet komunikimit elektronik (e-mail) raporti u përcoll tek 27 Organizata të Shoqërisë Civile. OSHC- kanë pasur 10 ditë afat për të dërguar komente/sugjerime, deri në datën 6 gusht 2021.
- Gjithashtu, u realizua dhe konsultimi online në faqen e OGP-së. Në datën 5 gusht 2021 Raporti i Vetëvlerësimit për zbatimin e PV OGP, për vitin 2020 e 6M 1 2021, komponenti 4, objektivi 8 – Transparenca në Buxhet dhe objektivi 9 – Transparenca e të Ardhurave, u publikua në faqen e OGP-së për konsultimin me OSHC-të, akademikët, qytetarët e të gjithë të interesuarit draftin e raportit të vlerësimit. Afati për dërgimin e komenteve ishte 6 ditë, deri në datën 10 gusht 2021.
- Nuk ka pasur komente nëpërmjet konsultimit online nga OSHC-të, akademikët apo qytetarët.

IV.Lista me OSHC-të e kontaktuara

Komponenti 1: Antikorrupsion

- Raporti i vetëvlerësimit për periudhën Janar- Dhjetor 2020 (raport vjetor) dhe Janar-Qershor 2021, Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur, 2020-2022, për për komponentin antikorrupsion është dërguar drejtpërdrejt në OSHC-të që e kanë bashkë-hartuar/ bashkë-bërë, një rrjet i organizatave bashkëpunëtoresh në MD për procesin PQH/OGP. Raporti është publikuar gjerësisht përmes platformës OGP, i hapur për palët e interesuara dhe publikun.

Lista si më poshtë:

1. IDM (Institut për Demokraci dhe Ndërmjetësim)
2. ALTRI (Instituti Shqiptar i Kërkimeve Juridike dhe Territoriale)
3. ICC (Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë)
4. NDI (Instituti Demokratik Kombëtar)
5. ACER (*Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike*)
6. CDI (*Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit*)
7. EMA (Lëvizja Evropiane Shqiptari)
8. Different & Equal (të ndryshëm & të barabartë)
9. KSHH (Komiteti Shqiptar i Helsinkit)
10. CRCA (*Qendra për të Drejtat e Fëmijëve Shqiptari*)
11. *Partners Albania (Partnerët Shqiptari për Ndryshim dhe Zhvillim)*

Komponenti 2: Qeverisja Digjitale

Lista si më poshtë:

1. Albania Transparency Academy Support Project,
2. Organizata/Lëvizja MJFT
3. Institute VISUM /For The Blinds.

Komponenti 3: Qeverisja e Hapur në Drejtësi

Lista si më poshtë:

1. Fakulteti i Drejtësisë, Përfaqësues e Klinikës së Ligjit
2. Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri
3. CRCA
4. Organizata për Mbrojtje e Personave me Aftësi të Kufizuar
5. Qendra Altri
6. Dhoma Kombetare e Ndërmjetësimit
7. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas

Komponenti 4: Qeverisja e Hapur Fiskale

Lista si më poshtë:

1. Lëvizja Evropiane Shqipëri,
2. Fondacioni i Shoqërisë së Hapur/ SOROS,
3. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Çështjet e BE -së,
4. Instituti Shqiptar i Medias,
5. BIRN Albania,
6. Fondacioni Shqiptar për zgjidhjen e konflikteve,
7. Agjencia e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik,
8. Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale,
9. Instituti i Politikave Publike Private,
10. Qendra e Politikave Shqiptare,
11. Instituti i Shkencës/ Open Data Albania,
12. Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit,
13. Instituti Shqiptar i Studimeve Politike,
14. Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut,
15. Shqipëria Aktive e Romëve,
16. LGBTI,
17. Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare,
18. Të ndryshëm dhe të barabartë (lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore),
19. Fshati SOS Shqipëri,
20. Koalicioni Shqiptar për Arsimin,
21. Biznesi social mbi aftësinë e kufizuar,
22. Co-Plan- Instituti për Zhvillimin e Habitatit,
23. Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare
24. Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare,
25. Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER),
26. Studiues i pavarur i politikave sociale,
27. Qendra për Aleancën Gjimore për Zhvillim (GADC),

V.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

- Lidhur me komponentin 1/antikorrupsion nuk ka pasur komente nga aktorët e interesit, OSHC-të apo publiku i gjërë.
- Lidhur me komponentin 2/qeverisja digjitale kontributi që është marrë nga përfaqësues të Grupit Tematik dhe shoqëria civile ka qenë pozitiv, duke dakordësuar përmbajtjen e dokumentit. Ka pasur vetëm tre komente nga përfaqësues të Grupit Tematik, të cilat nuk u reflektuan në draftin e raportit të vetëvlerësimit pasi nuk lidheshin direkt me zbatimin e Planit të Veprimit përmes indikatorëve të tij, por ishin informacione sqaruese shtesë lidhur me përmbajtjen e dokumentit.
- Lidhur me komponentin 3/drejtësi e hapur rezulton se gjatë procesit të konsultimit në të treja format e sipërpërmendura nuk kanë ardhur komente apo sugjerime.
- Lidhur me komponentin 4/qeverisje fiskale Instituti Shqiptar i Shkencave AIS/Albanian Institute of Science AIS, ka dërguar tre komente. Komentet u përcollën tek njësitë përgjegjëse dhe u bënë reflektimet përkatëse në raport. Të gjitha komentet (100 %) u reflektuan. Në mënyre të përmbledhur komentet dhe reflektimet përkatëse janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr	Komenti	Statusi i reflektimit
1	Kur deklaroni për dokumente që janë <i>lehtësisht të gjetshëm</i> apo <i>arrihet lehtësisht</i> për çfarë është fjala? Pra duhet përshkruar teknikisht çfarë kuptoni standard publikimi OpenData, DataRow, Data Excel apo PDF. Teknikisht jo çdo gjë që publikohet ne web është lehtësisht e gjetshme dhe e arritshme. E mira do ishte që për çdo sistem, dokument, raport që ju keni listuar si angazhim për OGP transparenca fiskale, përbri të jepet edhe informacion mbi formatin apo standardin e publikimit. Po njësoj një raport mbi tregues fiskal dhe buxhetor do të duhet me patjetër të japë Informacion se sa nga të dhënat (fiskale dhe buxhetore) janë në format OpenData apo nëse ka pritshmëri për këtë standard. OGP ka synim finalaksesin e hapur në data dhe informacion. Shteti ka investuar dickeperkete standard.	U reflektua Për raportet e publikuara u shtua dhe formati i publikimit.
2	Disa element kërkojnë referencë më të saktë. Psh kur thuhet Standardi Kombëtar (cili është ky standard) dhe a është standard që garanton parime gjithëpërfshirëse. Duhet cituar standardi me datë dhe Ligj përkatës dhe referencë ndërkombëtare. E njëjta gjë për disa dokumenta që përmenden , do ishte mirë të kishin një link ilustrues. Psh <u><i>Udhëzuesi i buxhetit të Qytetarëve</i></u> ku është si dokument i aksesueshëm. A mund të vendosni një	U reflektua Ku kërkohet referencë për ‘standardi i kontabilitetit’, është saktësuar se i referohemi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP/IPSAS). Link për të gjithë raportet e publikuar është vendosur si footnote në raport.

	LINK për këtë Dokument në raport, dhe të tjerë dokumenta që citohen.	
3	Në raportin tuaj përmendni bashkëpunime dhe konsultime me shoqërinë civile, por në asnjë rast nuk listohet një produkt në bashkëpunim apo një raport vlerësimi me palë të tjera. Aktorët civil do të duhet të jenë më ndërveprues. Veprimi i tyre vetëm në nivel konsultimi apo përfitimi është jo fort në përshtatje me Plan Veprimet dhe Detyrat Angazhuese të Procesit të OGP. Nëse këto mungojnë duhen referuar nevoja për ndërveprim më konkret në të ardhmen.	<p>U reflektua</p> <p>Mbi bashkëpunimin e shoqërisë civile, sipas fushës së përgjegjësisë, për pjesën e dokumentave buxhetore (si p.sh ligji vjetor i buxhetit apo PBA) në rastet kur janë organizuar takime me shoqërinë civile, janë bërë përmbledhje dhe raportet janë publikuar në website.</p>

OGP

